



Rr. "Eqrem Çabej", nr. 93. Prishtinë, R. e Kosovës, Tel: +383 38 22 08 22, Tel/Fax: +383 38 224 156
www.institutialbanologjik.org. E-mail: institutialbanologjik@gmail.com

Mbështetur në dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, nenet 11, 14, 30, 31, 32, 33, 34, 35 dhe 36 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), nenin 13 dhe 14 të Statutit të Institutit të Albanologjik në Prishtinë, Udhëzimit Administrativ nr. 01/2018, për Parimet e Njohjes së Platformave dhe Revistave Ndërkombëtare me Recension, Udhëzimit Administrativ për Plotësimin dhe Precizimin (Aneksi I, MASHT) 7/2018 e UA 01/2018, për Parimet e Njohjes së Platformave dhe Revistave Ndërkombëtare me Recension dhe bazuar në propozimin e Këshillit Shkencor në mbledhjen e mbajtur me datën 17.01.2025, Këshilli Drejtues i Institutit Albanologjik, në mbledhjen mbajtur me datën 23.01.2025, miratoi:

RREGULLOREN PËR PROCEDURAT E ZGJEDHJES DHE RIZGJEDHJES SË PUNONJËSVE SHKENCORË DHE HULUMTUESVE NË INSTITUTIN ALBANOLOGJIK

Neni 1 Qëllimi

1. Kjo rregullore ka për qëllim rregullimin dhe përcaktimin e procedurave për zgjedhjen dhe rizgjedhjen e punonjësve shkencorë dhe hulumtues në titujt: bashkëpunëtor shkencor (*profesor asistent*), bashkëpunëtor i lartë shkencor (*profesor i asocuar*), këshilltar shkencor (*profesor i rregullt*), hulumtues (*asistent i ri*) dhe hulumtues i pavarur (*asistent*).
2. Çështjet që nuk janë të rregulluara në mënyrë shprehimore në Statutin e Institutit Albanologjik-Prishtinë (IAP) dhe në Ligjin për Veprimtari Kërkimore-Shkencore lidhur me procedurat vlerësuese për zgjedhjen dhe rizgjedhjen e punonjësve shkencorë dhe hulumtues, rregullohen në dispozitat vijuese të kësaj rregulloreje.

Neni 2 Punonjësit shkencorë dhe hulumtues

Në pajtim me nenin 12, paragrafi 2 dhe 3 të Statutit të Institutit Albanologjik dhe Ligjit për Veprimtari Kërkimore - Shkencore, nr.04/L-135 të datës 28.03.2013, përkatësisht nenet: 30, 31, 32, 33, 34 dhe 35, punonjësit shkencorë dhe hulumtues të Institutit Albanologjik përbëhen nga: bashkëpunëtorë shkencorë (profesorë asistentë), bashkëpunëtorë të lartë shkencorë (profesorë të asocuar), këshilltarë shkencorë (profesorë të rregullt), hulumtues (asistentë të rinj) dhe hulumtues të pavarur (asistentë).

Neni 3 Kriteret për zgjedhjen dhe rizgjedhjen në titujt shkencorë dhe hulumtues

1. Për zgjedhjen dhe rizgjedhjen e kandidateve në titujt përkatës kërkohet plotësimi i minimumit të kriterëve të parapara me Ligjin për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, Statutin e IAP-it dhe në shtojcat përkatëse të kësaj rregulloreje.

2. Shtojcat I dhe II janë pjese përbërëse të rregullores, të cilat mund të plotësohen nga organet e Institutit në bazë të indeksimit të revistave.

Neni 4

Zgjedhja/rizgjedhja në titullin bashkëpunëtor shkencor (profesor asistent)

1. Në pajtim me nenin 13 të Statutit të Institutit Albanologjik, për titullin e bashkëpunëtorit shkencor (profesorit asistent), në kohëzgjatje prej katër (4) vjetësh, kandidati duhet të ketë këto kualifikime:

- 1.1. Të ketë gradën e doktorit të shkencave;
- 1.2. Të ketë të botuar së paku një vepër shkencore autoriale nga institucionet shkencore;
- 1.3. Të ketë së paku një punim (1) shkencor të publikuara në revista shkencore relevante kombëtare dhe ndërkombëtare nga fusha përkatëse;
- 1.4. Të ketë pjesëmarrje në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, së paku dy (2) konferenca, nga të cilat një (1) ndërkombëtare.
- 1.5. Të tregojë nivel të lartë kompetence e përvojë shkencore për fushën përkatëse (gjuhësi, letërsi, histori, folklor, etnologji) që dëshmohet;
- 1.6. Të ketë rezultate të dëshmuara në sferën e kërkimeve shkencore.

2. Bashkëpunëtori shkencor mund të rizgjidhet në titullin e njëjtë edhe për një mandat, në kohëzgjatje prej katër (4) vjetësh.

Neni 5

Zgjedhja/rizgjedhja në titullin bashkëpunëtor i lartë shkencor (profesor i asociuar)

1. Në pajtim me nenin 13 të Statutit të Institutit Albanologjik, për titullin e bashkëpunëtorit të lartë shkencor (profesorit të asociuar), në kohëzgjatje prej katër (4) vjetësh, kandidati duhet të ketë këto kualifikime:

- 1.1. Të ketë gradën e doktorit të shkencave;
- 1.2. Të ketë titullin kërkimor shkencor paraprak bashkëpunëtor shkencor (profesor asistent);
- 1.3. Të ketë të botuara së paku dy vepra shkencore autoriale nga institucionet shkencore, një prej të cilave pas zgjedhjes së fundit;
- 1.4. Të ketë së paku 3 punime shkencore të publikuara në revista shkencore relevante kombëtare dhe ndërkombëtare nga fusha përkatëse, dy (2) prej tyre pas zgjedhjes së fundit;
- 1.5. Të ketë pjesëmarrje në konferencat kombëtare dhe ndërkombëtare, së paku tri (3) konferenca, nga të cilat një (1) ndërkombëtare;
- 1.6. Përvojë në projekte shkencore, të cilat janë të udhëhequra nga institucionet shkencore, akademike dhe universitare;
- 1.7. Aftësi për udhëheqje të projekteve kërkimore-shkencore dhe akademike.

2. Bashkëpunëtori i lartë shkencor mund të rizgjidhet në titullin e njëjtë edhe për një mandat, në kohëzgjatje prej katër (4) vjetësh.

Neni 6

Zgjedhja në titullin këshilltar shkencor (profesor i rregullt)

1. Në pajtim me nenin 13 të Statutit të Institutit Albanologjik, për titullin e këshilltarit shkencor (profesorit të rregullt), kandidati duhet të ketë këto kualifikime:

- 1.1. Të ketë gradën e doktorit të shkencave;
- 1.2. Të ketë titullin kërkimor shkencor paraprak bashkëpunëtor i lartë shkencor

(profesor i asocuar);

1.3. Të ketë të botuara së paku tri vepra shkencore autoriale nga institucionet shkencore, një prej të cilave pas zgjedhjes së fundit;

1.4. Të ketë së paku 5 punime shkencore të publikuara në revista shkencore relevante kombëtare dhe ndërkombëtare nga periudha përkatëse, tri (3) prej tyre pas zgjedhjes së fundit;

1.5. Të ketë pjesëmarrje në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, pas zgjedhjes së fundit, së paku pesë (5) konferenca, nga të cilat dy (2) ndërkombëtare.

1.6. Aftësi për udhëheqje të projekteve kërkimore-shkencore dhe akademike;
Titulli këshilltar shkencor është i përhershëm.

Neni 7

Zgjedhja në titullin hulumtues (asistent i ri)

1. Në pajtim me nenin 14 të Statutit të Institutit Albanologjik, hulumtues (asistent i ri), në kohëzgjatje prej tri (3) vjetësh, zgjidhet kandidati që duhet të ketë këto kualifikime:

1.1. Të ketë të përfunduar studimet *bachelor* dhe ato *master* në drejtimin përkatës;

1.2. Të jetë jo me i vjetër së 27 vjet kur zgjidhet për herë të parë (të mos i ketë mbushur 27 vjet nëse zgjidhet për herë të parë);

1.3. Të ketë notën mesatare së paku tetë (8) në studimet *bachelor* dhe *master*.

1.4. Të njohë një gjuhët të huaj në nivel të nevojshëm për komunikim.

2. Hulumtuesi mund të rizgjidhet në titullin e njëjtë edhe për një mandat, në kohëzgjatje prej tri (3) vjetësh.

3. Hulumtuesit do t'i caktohet një udhëheqës shkencor nga radhët e punonjësve të Institutit, për realizimin e objektivave të tij/saj në avancimin shkencor.

Neni 8

Zgjedhja/rizgjedhja në titullin hulumtues i pavarur (asistent)

1. Në pajtim me nenin 14 të Statutit të Institutit Albanologjik, për titullin e hulumtuesit të pavarur (asistent), në kohëzgjatje prej tri (3) vjetësh, zgjidhet kandidati që duhet të ketë këto kualifikime:

1.1. Të ketë shkallën e magjistrisë të shkencave (para Bolonjës) ose gradën master i shkencave (sipas Bolonjës), në drejtimin përkatës;

2.2. Të ketë të regjistruar studimet e doktoratës në fushën përkatëse;

3.3. Të njohë një gjuhët të huaj në nivel të nevojshëm për komunikim;

4.4. Të ketë notën mesatare në studimet *bachelor* dhe *master*, jo më pak se 8 në secilën prej këtyre niveleve të studimeve.

2. Hulumtuesi i pavarur shkencor mund të rizgjidhet në titullin e njëjtë edhe për një mandat, në kohëzgjatje prej tri (3) vjetësh.

3. Në rastet e veçanta kur hulumtuesi i pavarur ndodhet në fazën përfundimtare të mbrojtjes së temës së doktoratës në Universitetin/Institutin përkatës, atij/asaj do t'i vazhdohet marrëdhënia e punës në Institut Albanologjik edhe për një periudhë kohore deri në një vit, me kusht që të dëshmojë të paktën një muaj para përfundimit të kontratës së punës, përmes një vërtetimi nga Universiteti/Institutin përkatës, se tema e doktoratës është në procedurë mbrojtjeje.

4. Hulumtuesit të pavarur do t'i caktohet një udhëheqës shkencor nga radhët e punonjësve të Institutit, për realizimin e objektivave të tij/saj në avancimin shkencor.

Neni 9

Procedurat e konkursit

1. Procedura e zgjedhjes/rizgjedhjes, do të bëhet në mënyrë transparente dhe me shpalljen, e konkursit publik për pozitën përkatëse në ueb faqen zyrtare të Institutit Albanologjik.

1.1. Konkursi duhet të përmbajë referencën e neneve përkatëse të Ligjit për veprimtari Kërkimore-Shkencore, Statutit të Institutit Albanologjik, Ligjit të Punës dhe të kësaj rregulloreje.

2. Kohëzgjatja e konkursit është pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike.

3. Konkursi për zgjedhje dhe rizgjedhje shpallet me vendim të Këshillit Shkencor të Institutit.

4. Kandidatët që i kanë mbaruar studimet jashtë vendit me rastin e aplikimit për zgjedhje, rizgjedhje apo avancim, duhet të sjellin vendimin për nostrifikimin (barasvlerën) e diplomës përkatëse (bachelor, master, magjistraturë, doktoratë).

5. Kërkesat me dokumentacionin përkatës nga kandidatët, dorëzohen drejtpërdrejt në Institut ose nëpërmjet postës në adresën: Instituti Albanologjik i Prishtinës, Rr. "Eqrem Çabej", nr. 93, Prishtinë.

Neni 10

Komisioni vlerësues

1. Mendimin se kandidati i plotëson kushtet për zgjedhje në titullin shkencor ose në titullin hulumtues, sipas konkursit publik, e jep komisioni vlerësues, i emëruar nga Këshilli Shkencor i Institutit, në bazë të propozimit të Degës përkatëse.

2. Në rast të mungesës së propozimit nga Dega përkatëse, propozimi i komisionit vlerësues mund të bëhet edhe nga anëtarët e Këshillit shkencor.

3. Komisioni vlerësues profesional përbëhet së paku prej tre (3) anëtarëve, dy (2) prej të cilëve duhet të jenë nga fusha e ngushtë profesionale dhe nuk lejohet të jenë me tituj më të ulët se titulli kandidatit/es për të cilin e shkruajnë referatin.

4. Anëtarët e komisionit vlerësues mund të jenë edhe nga institute, akademi dhe universitete të tjera në vend dhe jashtë vendit. Në këtë rast, së paku një (1) anëtar i komisionit është i brendshëm, nga Instituti Albanologjik. Në rastet kur komisioni vlerësues ka dy (2) anëtarë të jashtëm, anëtari i brendshëm, me automatizëm, është kryetar i komisionit.

5. Në mungesë të anëtarëve në marrëdhënie të rregullt pune si në paragrafin 3,4, atëherë anëtarë të komisionit vlerësues mund të jenë edhe personat e pensionuar, që kanë titujt e duhur akademikë nga fusha përkatëse.

6. Nëse ekzistojnë arsye të bazuara, një anëtar i komisionit vlerësues mund të paraqesë me shkrim dorëheqjen nga komisioni brenda pesë (5) ditëve pas formimit të tij. Në këtë rast, drejtori i Institutit thërret një mbledhje të Këshillit Shkencor dhe, pas aprovimit të dorëheqjes nga Këshilli Shkencor, kërkon nga ky organ plotësimin e përbërjes ose formimin e një komisioni tjetër vlerësues.

7. Kryetari i komisionit vlerësues është i obliguar të thërrasë anëtarët e tjerë të komisionit dhe ta hartojë dhe dorëzojë raportin e vlerësimit për kandidatët e paraqitur në konkurs.

Neni 11

Referati i komisionit vlerësues

1. Referati i komisionit vlerësues duhet të përmbajë:
 - 1.1. Shënimet biobibliografike të kandidatit;
 - 1.2. Vlerësimin e punës së tij shkencore, si dhe
 - 1.3. Propozimin për zgjedhje/rizgjedhje.
2. Komisioni vlerësues, me rastin e dhënies së propozimit për zgjedhjen e punonjësit në titullin shkencor ose hulumtues, duhet të ketë parasysh dispozitat ligjore dhe aktet e tjera nënligjore, për vlerësimin e punës kërkimore-shkencore.
3. Komisioni vlerësues u jep përparësi kandidateve, të cilët i plotësojnë kriteret e nevojshme dhe të cilët, bazuar në vlerësimin e përgjithshëm të aktivitetit të tyre shkencor, profesional dhe akademik, janë më të mirë në krahasim me kandidatët tjerë. Komisioni duhet të arsyetojë rekomandimin e bërë në frymën e këtij paragrafi.
4. Në raportin e komisionit vlerësues duhet të bëhet i qartë propozimi për zgjedhjen apo rizgjedhjen e kandidateve në numrin e kërkuar me konkurs dhe të dallohet nga propozimi për kandidatët, të cilët nuk janë zgjedhur.
5. Komisioni vlerësues është i obliguar të shkruajë raport edhe për kandidatet të cilët i plotësojnë kushtet minimale, por të cilët nuk janë propozuar të zgjedhen/rizgjedhen. Për kandidatët të cilët nuk i plotësojnë kushtet minimale mjafton të theksohen kushtet (e parapara në konkurs) të cilat nuk janë plotësuar.
6. Nëse ndonjëri nga anëtarët e komisionit vlerësues ka mendim të ndryshëm në lidhje me propozimin për zgjedhjen/rizgjedhjen e kandidatit, ai anëtar është i obliguar që të paraqesë një *propozim të ndarë* për Këshillin Shkencor. Vlerësimet në raport bëhen në përputhje me kriteret e kërkuar me konkurs dhe kërkesat e përcaktuara në Statut dhe të detajuara në këtë rregullore.
7. Anëtarët e komisionit vlerësues mbajnë përgjegjësi ligjore, disiplinore dhe etike për vërtetësinë e të dhënave të shënuara në raportin e vlerësimit dhe për rekomandimet që bëjnë. Në rast se rekomandimet e tyre bien qartazi ndesh me Ligjin Nr. 04/1-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, Statutin e Institutit dhe këtë rregullore, veprimet e tyre do të sanksionohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.
8. Referati, sipas paragrafit 1 të këtij neni, vihet në diskutim publik më së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë para marrjes së vendimit.
9. Këshilli Shkencor i Institutit, në bazë të mendimit të komisionit vlerësues, merr vendim për zgjedhjen e kandidatit të propozuar në titullin përkatës shkencor ose hulumtues.
10. Procedura e konkursit duhet të përfundojë brenda afatit prej tre muajsh.

Neni 12

Lidhja e marrëdhënies së punës

1. Punonjësit shkencorë dhe hulumtues në Institut e lidhin kontratën e punës me Institutin Albanologjik ose me personin tjetër juridik kërkimor-shkencor, në bazë të legjislacionit në fuqi.

2. Administrata e Institutit Albanologjik është e obliguar që brenda shtatë (7) ditësh pas vendimit të Këshillit Shkencor, t'i njoftojë kandidatët pjesëmarrës në procesin e zgjedhjes/rizgjedhjes mbi vendimin.

3. Ndaj vendimit të Këshillit Shkencor, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas pranimi të njoftimit për vendimin, mund të bëhet ankesë në komisionin për ankesa të Institutit.

Neni 13 **Ndërprerja e Kontratës**

1. Kontratën e punës me punonjësit shkencorë dhe hulumtues, Instituti e ndërpret:

1.1. Në qoftë se punonjësi shkencor ose hulumtuesi, për shkak se nuk rizgjidhet në titullin e paraparë e humb statusin e punonjësit shkencor ose të hulumtuesit;

1.2. Në rast se në bazë të konkursit publik në vend të tij zgjidhet punonjësi tjetër shkencor ose hulumtues;

1.3. Me kërkesën e punonjësit shkencor ose të hulumtuesit;

1.4. Nëse punonjësi shkencor ose hulumtuesi nuk e realizon projektin shkencor sipas mënyrës së përcaktuar në kontratë;

1.5. Në qoftë se punonjësi shkencor ose hulumtuesi bën shkelje të rëndë të detyrave të punës, ose me sjelljet e tij cenon rëndë autoritetin e Institutit;

1.6. Në rastet e tjera të përcaktuara me ligj.

2. Lidhja dhe ndërprerja e marrëdhënies së punës, si dhe të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella ndërmjet punonjësve shkencorë e hulumtues dhe Institutit Albanologjik, përcaktohen me akt të veçantë të marrëdhënies së punës.

Neni 14 **Kohëzgjatja e zgjedhjes/e rizgjedhjes dhe kufizimet**

1. Të gjitha zgjedhjet/rizgjedhjet për tituj si dhe kohëzgjatja e punësimit, bëhen në përputhje me dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04/1—135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore dhe Statutit të Institutit Albanologjik.


2. Avancimi nuk është proces automatik, por është konkurrues dhe meritore për të gjitha pozitat.

3. Zgjedhja/rizgjedhja në thirrjet shkencore dhe hulumtuese, bëhet sipas renditjes: hulumtues, hulumtues i pavarur, bashkëpunëtor shkencor, bashkëpunëtor i lartë shkencor dhe këshilltar shkencor.

4. Nuk lejohet tejkalimi i thirrjes apo zgjedhjes/rizgjedhjes se parakohshme.

Neni 15 **Dispozitat përfundimtare**

1. Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues i Institutit Albanologjik.

Kryesuesi i Këshillit Drejtues

Prof. asoc. dr. Naim Berisha

Shtojca I

Botimi i veprave shkencore

Në përputhje me Statutin e Institutit Albanologjik, Ligjin për Veprimtari Kërkimore-Shkencore dhe Rregulloren e Veprimtarisë Botuese të Institutit Albanologjik, vepra shkencore vlerësohet për nevoja të zgjedhjes, rizgjedhjes dhe avancimit të punonjësve shkencorë.

Instituti Albanologjik boton vepra shkencore dhe profesionale të punonjësve të Institutit ose të bashkëpunëtorëve të tij të jashtëm që janë përfshirë në planin botues të Institutit.

Veprat e botuara të punonjësve të Institutit janë rezultat i punës së tyre kërkimore-shkencore e profesionale, të parapara si projekte shkencore të Institutit.

A.1. Vepër shkencore konsiderohet botimi monografik që rrjedh si rezultat i realizimit të projektit kërkimor-shkencor individual të punonjësit shkencor të Institutit.

A.2. Një vepër shkencore është e barasvlershme me botimin e: dy (2) botime me përmbledhje punimesh; dy (2) fjalorëve gjuhësorë, tematikë e shpjegues; dy (2) vëllimeve nga blejtë e folklorit; dy (2) vëllimeve me dokumente të rëndësishme historike, apo dy botime si bashkautor në monografi shumautorëshe që dalin si produkt i punës ekipore nga ana e punonjësit shkencor të Institutit.

A.2.1. Në raste të veçanta, vepra shkencore është e barasvlershme me: një (1) botim me përmbledhje punimesh, si dhe me dy punime shkencore shtesë nga kriteret e përgjithshme për secilin titull shkencor në procesin e avancimeve, me kusht që të ofrohet dëshmi nga Dega përkatëse që projekti individual (monografia, vepra shkencore) është në realizim e sipër dhe do të jetë në proces botimi sipas planifikimit.

A.2.2 Gjithashtu, vepra shkencore është e barasvlershme me: një (1) botim me përmbledhje punimesh dhe një nga botimet e tjera sipas pikës **A.2.**

A.3. Botimet e atlaseve, bibliografive dhe katalogëve janë të barasvlershme me një punim në revista shkencore.

Kryesuesi i Këshillit Drejtues

Prof. asoc. dr. Naïm Berisha

Shtojca II

Punimet e publikuara në revista shkencore

Në përputhje me Statutin e Institutit Albanologjik dhe Ligjin Nr. 04/1-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore dhe Udhëzimin Administrativ (MASHT) Nr. 01/2018, punimi i botuar në revista kombëtare dhe ndërkombëtare shkencore, mund të vlerësohet për nevoja të zgjedhjes, rizgjedhjes dhe avancimit.

B.1. Bazuar në Statutin e Institutit Albanologjik, Ligjin Nr. 04/1-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore dhe aktet tjera ligjore në fuqi, si punime të botuara në revista shkencore kombëtare dhe ato ndërkombëtare gjatë vlerësimit të kandidateve të paraqitur në konkurs, vlejné punimet e botuara në fushën e kandidatit, në revista dhe platformat e parapara në këtë Rregullore si në pikat vijuese (B.1.1., B.1.2., B.1.3., B.1.4.):

B.1.1. Punimet e botuara në revista kombëtare:

1. Gjurmime Albanologjike (IAP, <https://www.ceeol.com/>)
2. Studime Filologjike (<https://akad.gov.al/periodiket/>)
3. Studime (<https://ashak.org/seksioni/studime/>)
4. Studime Historike (<https://akad.gov.al/periodiket/>)
5. Kosova (<http://ih-rks.org/revista-kosova/>)
6. Studime albanologjike (<https://www.itsh.edu.mk/studime-albanologjike>)

B.1.2. Punimet e botuara në revista ndërkombëtare, të cilat janë të indeksuara në bazat akademike vijuese:

1. Web of Science: Core Collection (<https://mjl.clarivate.com/home>)
2. Scopus (Elsevier) (<https://www.elsevier.com/solutions/scopus>)
3. EBSCOhost (<https://www.ebsco.com>)
4. WorldCat (<https://www.worldcat.org/>)
5. Directory of Open Access Journals (<https://doaj.org/>)

B.1.3. Si punime të botuara në revista shkencore kombëtare vlejné edhe botimet e punimeve në revistat e institucioneve publike shkencore dhe akademike, si: institutet, akademitë, universitetet. Punimet e publikuara në revistat të këtij niveli institucional shkencor mund të vlerësohen sa gjysma e vlerës së një punimi në revistat e përmendura në pikën **B.1.1.** dhe **B.1.2.**

B.1.4. Punimet e publikuara në aktet e konferencave, seminareve dhe simpoziumeve të institucioneve publike shkencore dhe akademike mund të vlerësohen sa gjysma e vlerës së një punimi në revistat e përmendura në pikën B.1.1.

Kryesuesi i Këshillit Drejtues

Prof. asoc. dr. Naim Berisha